

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Kamenicë, përmes gjyqtarit, **Sadri Krasniqi**, me sekretaren juridike **Resmije Krasniqi**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **Qemajl Rexhep Beqiraj** nga fsh.Kopërnice, për shkak të kundërvajtjes nga neni 8.1, lidhur me nenin 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, parag.1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, e në bazë të nenit 9,73,74,195 dhe 199 të Ligjit për kundërvajtjet, më **02.11.2012**, horto

A K T V E N D I M

I pandehuri **Qemajl Rexhep Beqiraj**, i lindur më 26.03.1964 në fsh.Kopërnice, këshilltar në Asamblenë Komunale në Kamenicë, i martuar, prind i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar për kundërvajtje, nuk është nën hetime, me vendbanim të përhershëm në fsh.Kopërnice,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse si zyrtarë i lartë publik, këshilltarë në Asamblenë Komunale në Kamenicë, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, në Agjencinë Kundër Korrupsionit,

-me ç'rast i pandehuri ka shkaktuar kundërvajtje nga neni 8.1, lidhur me nenin 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, parag.1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, andaj në bazë të dispozitave të të njejtë ligj, e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 9 të Ligjit për kundërvajtjet,

D Ë N O H E T

Me të holla në shumë prej **450 €**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta arkëtoi në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën, dënimi me të holla do t'i zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **30. ditësh**, duke logaritur një ditë burgu 15 €.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, në afatin e lartëcekur, të arkëtoi shumën prej 5 €.

Dënimin dhe paushallin gjyqësor i pandehuri e arkëton në këtë gjykatë.

Me aktvendim të njoftohet i pandehuri dhe parashtuesi i kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën nr. 01-2332/12, të parashtuar më 18.07.2012, ka propozuar që kundër të pandehurit **Qemajl Rexhep Beqiraj** nga fsh.Kopërnice, të fillohet dhe shtjellohet procedura kundërvajtëse, për shkak të kundërvajtjes nga neni 9, lidhur me nenin 5 dhe 6, parag.1.3, e sanksionuar sipas nenit 17, parag.1.3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata vlerësoi kërkesën dhe pas shqyrtimit të së njejtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatop se kërkesa është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njejtës, ka caktuar séancë gjyqësore për shqyrtim kryesor kundër të pandehurit, më 15.10.2012, i cili gjatë paraqitjes së mbrojtjes së tij e pranon kundërvajtjen për të cilën ngarkohet sipas kërkesës, njëherit edhe fajsinë, duke thekësuar se është e vërtetë se me kohë është njoftuar prej zyrtarit komunal për afatin e deklarimit të pasurisë, por nga pakujdesia, duke menduar se pasi që është fundi mandati i tij këshilltar komunal, nuk ka nevojë që ta deklaroj pasurinë, njëherit kërkon prej gjykatës që nëse eventualisht e shpallë fajtorë, me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh faktin se nga të ardhurat mujore që merrë si këshilltarë komunal në shumë prej 200 €, siguron ekzistencën e tij dhe të familjesë.

Me qëllim të vërtetimit dhe konstatimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjatë procedurës është dëgjuar edhe dëshmitari, **Fisnik Kastrati**, zyrtar juridik i Shërbimeve publike në Kamenicë, njëherit personi kontaktues me Agjencinë Kundër Korrupsionit, i cili deklaron se në momentin e marrëjes së formularëve prej agjensionit, menjëher në të dy gjuhët i ka njoftuar të gjithë zyrtarët e lartë publikë, të cilët sipas ligjit janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë dhe ate më 27.02.2012, ku si dëshmi ekzistojnë nënshkrimet e zyrtarëve që kanë pranuar njoftimin me shkrim dhe më 20.03.2012. njoftimin me shkrim i a ka bashkangjitur materilit për séancën e kuvendit.

Lidhur me rastin në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar edhe **Enis Sadiku**-zyrtar i lartë për mbikqyrjen e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili në séancën gjyqësore të mbajtur më 30.10.2012, deklaroi se agjensioni nuk është i obliguar, njëherit edhe nuk ka mundësi që çdo zyrtar ligjor personalisht ta njoftoj, por pran çdo institucioni ka një zyrtar kontaktues, për Kamenicë është caktuar Fisnik Kastrati, andaj pasi që zyrtari i lartëcekur nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2012, kundër të njejtit është parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse.

Gjykata duke e vlerësuar drejtë mbrojtjen e të pandehurit, dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dhënat tjera në kërkesë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike dhe konstatoj se i pandehuri Qemajl Beqiraj, si zyrtarë i lartë publik, këshilltarë në Ansamblenë Komunale në Kamenicë, nuk e ka bërë deklarinimin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012, andaj gjykata bëri rikualifikim e kundërvajtjes dhe gjeti se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e kundërvajtjes nga dispozitat e nenit 8.1, lidhur me nenin 5 dhe 6, pika 1.2 e sanksionuar sipas nenit 17, paragrafi 1.1 të Ligjit për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, nr.04/L-050, për të cilën kundërvajtje gjykata të pandehurin e shpalli fajtor dhe e dënoi me të holla në shumën prej 450 €.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësin e dënimit ndaj të pandehurit për kundërvajtjen e kryer, gjykata vlerësoi rrethanat të cilat në kuptim të nenit 7 të Ligjit për kundërvajtjet, ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, për këtë rast si rrethana lehtësuese pati parasysh se i pandehuri për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër kundërvajtëse, pakujdesinë e tij që të bëjë deklarinimin e pasurisë për faktin se këshilltarët komunal sipas ligjit, këtë vit për herë të parë janë të obliguar që të deklarojnë pasurinë, si dhe faktin se nga të ardhurat mujore që merrë si këshilltar komunal në shumën prej 200 €, siguron ekzistencën e tij dhe të familjesë. Duke vlerësuar se në të kundërtën shqiptimi i ndonjë dënimi më të lartë në të holla, do të vështërsonte gjendjen ekonomiko- sociale të tij dhe familjesë. Andaj gjykata vlerësoi se edhe me shqiptimin e dënimit në të holla në shumë si në dispozitiv, do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të pandehurit që në të ardhmën të mos kryej kundërvajtje të këtillë apo të ngjajshme. Në pajtim me nenin 9 të Ligjit për kundërvajtjet, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit bëri zbutjen e dënimit të përcaktuar me ligj për këtë kundërvajtje.

Vendimi për paushallin gjyqësor është shqiptuar në bazë të nenit 109 të Ligjit për Kundërvajtjet
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv aktvendimit.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË KAMENICË

Më 02.11.2012

GJYQTARI

Sadri Krasniqi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, për mëtejshëm këtë gjykatë.

